

Shtojca 19

BASHKIA PEQIN

Nr. 136 Prot.

Data 07.04.2014

FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT
KONTRAKTOR

Ankesë drejtuar: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Peqin

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërisht).

Shoqëria "VICTORIA INVEST" shpk

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L. 28 Nentori, rr. 11 Nentori, pallati prane Tatim Taksave, kati II

Adresa

Elbasan

Shqiperi

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

054246047

054246048

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

vicinvest@hotmail.com

E-mail

Fatmir KUÇI, administrator

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

2014/04/04

Firma e zyrtarit të autorizuar


Data (viti/muaji/dita)

054246047

054246048

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)



Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulencë (SHK), Konkurs Projektimi (KP).

Procedurë e Hapur(PH)

2. Autoriteti Kontraktor

Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

BASHKIA PEQIN

3. Vlera e Përlllogaritur e Prokurimit

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

22.247.382 (njetzet e dy milion e dyqind e dyzet e shtatemije e treqind e tetedhjetë e dy) leke pa tvsh.

4. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.

“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për qytetin e Peqinit”

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

2014/03/28 (28 MARS 2014)

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

2014

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkëlqen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

neni 63 i ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”



2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin ka zhvilluar tenderin me objekt **“Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për qytetin e Peqinit”**, me afat perfundimtar të dorezimit të ofertave 28 mars 2014 .

Ne date 01 prill 2014, shoqëria jone “VICTORIA INVEST” sh.p.k. është bere me dije ne faqen elektronike te app-se, per kuotimin e shoqerive pjesemarrese ne tender. Renditja elektronike është si me poshte :

Economic operator	Quotation	Rejected
Pastrime Silvio	20712471	No
VICTORIA INVEST	21023512	No
DU&KO	21409193	NO

Pra, sic shikohet nga klasifikimi i bere, autoriteti kontraktor Bashkia Peqin ka kualifikuar shoqerine “Pastrime Silvio” shpk , vleresim me te cilin shoqeria jone nuk është dakort për arsyet e meposhtme :

1.

Ne DST , ne shtojcen 7 ,Kapaciteti Teknik , pika 5, kerkohet :

5. *Kontiniere per grumbullimin e mbeturinave, me kapacitet 1.1 m/3, me kapak metalik, me rrota gome, me llamarine të xinguar; minimumi 30 cope.*
(Operatori ekonomik qe do te shpallet fitues duhet te plotesoje numrin prej 74 cope kontenieresh te percaktuar ne specifikimet teknike pjese e dokumentave te tenderit.)

Nga verifikimet e bera nga shoqeria jone , **“Pastrime Silvio” shpk nuk** disponon konteniere me **kapak metalik** , por kontenieret qe disponon jane **pa kapak metalik** , duke qene ne kundërshtim me kriterin kualifikues te DST .

Ju kerkojme qe te beni verifikimin perkates (ne baze te se drejtes tuaj per te bere verifikimin e gjendjes teknike te mjeteve per realizimin e kontrates, sic percaktohet ne DST).

2.

Ne DST , ne shtojcen 7 ,Kriteret e Vecanta te Kualifikimit , kerkohet :

Operatori ekonomik te paraqese nje vertetim qe ka paguar taksat vendore per vitin 2013.



Ne Ekstraktin e QKR te "Pastrime Silvio" shpk te dorezuar ne tender (por sic rezulton edhe ne website-n e QKR) , kjo shoqeri rezulton me seli dhe vend te ushtrimit te aktivitetit vetem ne qytetin e Tiranës .

Nderkohe qe kjo shoqeri prej disa vitesh ushtron aktivitet ne sherbimin e pastrimit te qytetit te Peqinit (me kontrate sipermarrje te dhene nga autoriteti kontraktor bashkia Peqin).

Ne ligjin nr.9920 dt.19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne R.SH." , ne nenin 40 "Regjistrimi i personave qe ushtrojne veprimtari tregtare dhe jotregtare" , pika 4 , percaktohet :

regjistrimi , ne perputhje me ligjin "Per Qendren Kombetare te regjistrimit"

Ne UDHËZIM Nr.24, datë 02.09.2008 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" , neni 40 , pika 4 , percaktohet :

Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikate regjistrimi për çdo adrese, e cila ka të njëjtin NIPT unik

Ne Ligjin Nr.9723, datë 3.5.2007 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT " , neni 43 "Regjistrimet e tjera te detyrueshme" , pika 3/d , percaktohet :

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

"Pastrime Silvio" shpk ka patur detyrimin ligjor qe te hape NIPT sekondar ne qytetin e Peqinit, duke bere edhe shtimin ne ekstraktin e QKR-se, dhe te paguaje taksat vendore , meqenese po ushtron aktivitet ne kete qytet . Duke mos e bere kete veprim , "Pastrime Silvio" shpk **eshte ne kundërshtim** me :

ligjin nr.9643 "Per prokurimin Publik" , neni 45 "**Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve**" , pika 2. "Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur:

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

(bashkangjitur keni legjislacionin perkates te cituar me lart)

3.

Ne DST , ne shtojcen 7 ,Kriteret e Vecanta te Kualifikimit , ne **Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë** kerkohet :

Drejtues teknik , inxhinier mekanik , inxhinier kimist

Si dhe : **List-pagesat te konfirmuara nga administrata tatimore** (ne DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit , kapaciteti teknik)



stepagesat e dorezuara ne tender nga "Pastrime Silvio" shpk nuk jane te konfirmuara (te rirmosura dhe te vulosura) te gjitha nga administrata tatimore . Ne listepagesat e paraqitura ne tender drejtuesi teknik dhe ing. Mekanik dhe kimist rezultojne me paga qe nuk jane ne baze te VKM nr.285 dt 04.05.2007 "PER PERCAKTIMIN E PAGES REFERUESE MUJORE, PER EFEKT TE LLOGARITJES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE....." dhe UDHËZIM Nr.10, datë 21.6.2007, kur qendra e shoqerise eshte ne Tirane, **ne kohen** kur VKM nr.285 dt 04.05.2007 dhe UDHËZIM Nr.10, datë 21.6.2007 **ishin me fuqi ligjore** .

Per arsyet e permendura me lart, kualifikimi i shoqerise "Pastrime Silvio" shpk eshte bere ne kundershtim me kriteret e DST, me ligjin nr.9643 "Per prokurimin Publik" dhe VKM nr.1 date 10.01.2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" .

Perfundimisht kerkojme qe te s`kualifikohet shoqeria "Pastrime Silvio" shpk ne tenderin me objekt "Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave urbane per qytetin e Peqinit" .

3. Lista e Shtojcave

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj** . Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet t'i referoheni Formularit të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

Nr. Faks:

E-mail: vicinvest@hotmail.com

Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

"VICTORIA INVEST" shpk

adm. Fatmir KUCI



FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: **“Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane në qytetin e Peqinit”**.

Kjo Kontratë është lidhur më **21.05.2014**, midis **Bashkise Peqin me adresë “Bulevardi Mustafa Gjinishi” Peqin**, tani e tutje të referuar si **“Autoriteti Kontraktor”** dhe **Bashkimi i operatoreve ekonomike “Pastrime Silvio” shpk. “Fusha” shpk**, sipas Kontrates per bashkepunim te perkohshem nr.646.rep/190.kol, date 25.03.2014, perfaqesuar per lidhjen e kontrates (prokure e posacme nr.646 rep/190 kol, date 25.03.2014) nga: Operatori ekonomik **“Pastrime Silvio” shpk. me adresë Rruga “Labinoti”, Pallati 2, Shkalla 11, Apartamenti 53, Tirane**, të përfaqësuar nga perfaqesuesi ligjor **zj.Bule Allmuca**, tani e tutje i quajtur si **“Kontraktuesi”**.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për kryerjen e shërbimeve, duke i'u referuar Prokurimit (objekti). **“Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane në qytetin e Peqinit”**.

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë **28.03.2014** bie dakord të realizojë Sherbimet, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- këtë Formular Kontrate
- Formularin e Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Kriteret e Përgjithshme/vecanta të pranimit
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur, përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **20.712.471 (njetemilion e shtateqind e dymbëdhjetemije e katerqind e shtatedhete e nje) leke pa tvsh** për kryerjen e shërbimeve;

Palët bien dakort si më poshtë:

Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: **828.499 (teteqind e njezet e tetemije e katerqind e nentedhete e nente) leke** dhe në formën e: Depozites bankare/Certifikates se Garancise në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.

1. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë shërbimet për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.



2. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për shërbimet e kryera, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
3. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
4. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 21/ 05/2014/ palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

PER AUTORITETIN KONTRAKTOR

BASHKIA PEQIN

KRYETARI

/ Ilir RRUSHI /



PER KONTRAKTUESIN

“PASTRIME SILVIO” sh.p.k.

ADMINISTRATORI

/ Bule ALLMUCA /





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Bashkia Peqin, Bulevardi "Mustafa Gjinishi", e-mail "bashki_peqin@yahoo.com"

Nr. 1 .Prot

Peqin , më 21.05.2014

Kontrate Publike per Kryerjen e Sherbimeve

"Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave urbane ne qytetin e Peqinit"

Kjo kontrate nenshkrhet sot me date 21.05.2014, ne Bashkine Peqin ndermjet dy paleve:

Autoriteti Kontraktor : Bashkia Peqin, perfaqesuar nga Kryetari z.Illir Rrushi
Adresa : Bulevardi "Mustafa Gjinishi" Peqin
Tel/Fax: (+355) 5122 (2234,2427,2217)
NIPT: K49701113D
Dhe
Kontraktuesi : Bashkimi i operatoreve ekonomike "Pastrime Silvio" shpk.
"Fusha" shpk, sipas Kontrates per bashkepunim te perkohshem nr.646.rep/190.kol, date 25.03.2014.
Perfaqesuar per lidhjen e kontrates (prokure e posacme nr.646 rep/190 kol, date 25.03.2014) nga: "Pastrime Silvio" shpk.
Adresa : Rruga "Labinoti", Pallati 2, Shkalla 11, Apartamenti 53, Tirane
NIPT : K91413010N
Perfaqesues ligjor : Bule Allmuca

KREU I : KUSHTE TE VECANTA

Neni 1 Baza ligjore

Kontrata mbeshtetet ne :

- Kodin Civil te Republikes se Shqiperise
- ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik"
- ligjit nr.8652, date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"
- ligjit nr.8094, date 21.03.1996 "Per largimin publik te mbeturinave"
- VKM nr.1, date 10.01.2007 "Per rregullat e prokurimit publik"
- VKM nr.319, date 21.04.1994 "Per prokurimin me siper marrje te sherbimeve publike te pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave"

Kontrata do te qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise.

Neni 2 Perkufizimet

"Kontrate" do te thote marreveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit, qe perbehet nga dokumentat e tenderit Procedure e Hapur "Sherbimi i pastrimit,



grumbullimit dhe sistemimit të mbeturinave urbane të qytetit të Peqinit” të zhvilluar me datë 03.03.2014, duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkëngjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjithë dokumentat e tjere që përfshihen në referimin e çdo dokumenti. Planimetria e zonës së pastrimit të Bashkisë Peqin, që përfshin sipërfaqen e pastrimit, pikat e vendosjes së 94 kontinierëve dhe vendi i depozitimit të mbeturinave.

“**Cmim kontrate**” do të thotë cmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontrates për zbatimin e plote dhe të përpikta të detyrimeve të tij kontraktore.

“**Objekti kontrates**” do të thotë të gjitha shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontrates.

“**Pale(t)**” do të thotë nënshkruesit e kontrates.

“**Autoriteti Kontraktor**” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“**Kontraktues**” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

“**Shërbime**” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

“**Termet e References**” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

“**Llogaritja e afateve**” të gjithë referencat e ditëve do të jenë kalendarike.

“**Mbeturina urbane**” (te ngurta) quhen të gjitha materialet organike dhe inorganike rezultat i konsumit të konsumatoreve.

“**Mbeturina të vëllimshe dhe inerte**” do të konsiderohen në kuptimin e kësaj kontrate mbetjet urbane voluminoze si : pajisje elektroshtepiake, karkasa makinash, mbetjet bimore të drunjtave, pjesë mobiljesh, orëdi dhe të gjitha llojet e objekteve të tjera të cilat për shkak të volumit, formës dhe përberjes së tyre nuk mund dhe nuk duhet të hidhen në kontinieret me volum 1. m³, të parashikuar për të kryer shërbimin. Në këtë grup do të përfshihen edhe mbeturinat solide inerte si : materiale mbetjesh ndertimore, germimesh dhe prishjesh, dherera, gure, materiale qeramike, zhavorë, etj. me prejardhje nga familjet.

“**Konsumatore**” quhen të gjitha subjektet private komerciale, shërbimi, artizanale, prodhuese, institucionale, tregjet e të gjitha llojeve, shërbimet ambulante dhe të gjithë banorët rezidentë apo ata që behen rezidentë gjatë kohës së kontratës brenda zonës që do të kryhet aktiviteti i Kontraktuesit me kufij sipas hartës së venë në dispozicion nga Bashkia Peqin, e cila është pjesë e kësaj kontrate. Në kategorinë e konsumatoreve përfshihen dhe zjarrefiksesit, komisariatet policie, Bashkia, të gjitha godinat publike dhe shtetërore si dhe të gjithë institucionet arsimore publike dhe private të qytetit, të cilat ndodhen brenda kufizimeve të zonës në të cilën do të kryhet shërbimi objekt i kësaj kontrate.

“**Edukim publik ambjental**” nënkupton përpjekjet për ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të konsumatoreve apo banorëve të qytetit me qëllim grumbullimin, transportin, largimin dhe manipulimin ose aspektet e tjera që lidhen me mbajtjen pastruese të ambjentit.

“**Zone e kontrates**” quhet hapësira e territorit brenda kufijve të përcaktuar në hartë. Kjo hartë është pjesë e kësaj kontrate, ku Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë shërbimet e pastrimit, administrimin e mbeturinave ndaj konsumatoreve ekzistues si dhe konsumatoreve që mund të shtohen gjatë kohezgjatjes së kontratës.

“**Mbeturina të rrezikshme**” Mbeturina të rrezikshme quhen mbeturinat e demshme ose toksike, që rrezikojnë shëndetin e personit, sjellin pasoja ekologjike dhe administrohen me ligje të veçanta.



“**Proces-Verbal**” quhet dokumenti i hartuar nga perfaqesuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkise Peqin mbi kontrollin e ushtruar ne terren qe reflekton punen e pakryer, gjobat dhe penalitetet e vendosura ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate, cilesine e sherbimit te pastrimit dhe problemet e konstatuara gjate kontrollit.

“**Preventivi**” quhen vellimet e punes te plotesuara me cmime, pjese perberese e kontrates.

“**Situacioni**” quhet dokumenti i evidentimit faktik te situacionit se punes se kryer ne perputhje me zerat e sherbimeve te percaktuara ne kontrate(volumeve), ne perputhje me procesverbalet ditore, te hartuar nga perfaqesuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkise Peqin.Situacionet jane ditore, mujore dhe vjetore.

“**Vlera totale e kontrates**” quhet shumatorja e viteve kontraktuale ne perputhje me preventivat e sherbimeve pjese perberese e kesaj kontrate duke perfshire dhe rishikimin e cmimit ne perputhje me inflacionit e deklaruar.

“**Supervizori**” quhet personi kompetent i emeruar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin, i cili eshte pergjegjes per mbikqyrjen e realizimit te sherbimit te pastrimit dhe administrimit te kontrates.

“**Drejtori Teknik i sherbimit te pastrimit**” eshte personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin, perfaqesues i Kontraktuesit, pergjegjes per kryerjen e sherbimeve te pastrimit.

“**Vend Depozitimit te Mbeturinave (VDM)**” eshte hapesia ne te cilen do te depozitohen dhe manipulohen mbeturinat urbane nga kontinieret dhe zona perreth kontinierëve sic eshte percaktuar ne harte dhe ne specifikimet teknike bashkengjitur kesaj kontrate.

Neni 3 Objekti i Kontrates

Objekti i kesaj kontrate eshte sherbimi i pastrimit, grumbullimit, sistemimit dhe manipulimit te mbeturinave urbane te qytetit te Peqinit.

Neni 4 Afati i Kontrates

Afati i kesaj kontrate eshte 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj kalendarike nga data e nenshkrimit te kontrates.Kontrata hyn ne fuqi dite e nenshkrimit te saj nga palet dhe fillon efektet e saj me date 22.05.2014, ora 00.00, kohe ne te cilen kontraktuesi fillon pune menjehere.

Kontrata do te jete me mundesi rinovimi ne fillim te cdo viti kontraktual pas analizes se realizimit te detyrave vjetore.

Autoriteti kontraktor mund te refuzoje rinovimin per mosperputhje te detyrimeve vjetore te kontrates dhe per mosrealizime te volumit te sherbimeve ne nje mase te konsiderueshme per faj te Kontraktuesit, te cilat kane shkaktuar dem per Autoritetin Kontraktor.

Neni 5 Vlera Vjetore e Kontrates

Vlera vjetore e kontrates qe do i paguhet kontraktuesit per zbatimin e perpikete te kontrates eshte :

Vlera e kontrates eshte 6.904.157 (gjashtemilion e nenteqind e katermije e njeqind e pesedhjete e shtate) leke pa tvsh.

Vlera e kontrates eshte 8.284.988 (tetemilion e dyqind e tetedhjete e katermije e nenteqind e tetedhjete e tete) leke me tvsh.

Kjo vlere eshte per kryerjen e sherbimit per 12 muaj ose 365 dite.



cmimi i kontrates do te paguhet per realizimin e sherbimit llogaritur sipas cmimeve per njesi te formularit te Cmimit te Ofertes.

Ne cmimin e kontrates perfshihen e gjithë ngarkesa fiskale qe parashikon legjislacioni shqiptar

Neni 6 Preventivi Sherbimeve

Vleresimi i zerave te sherbimeve do te kryhet ne baze te preventivit te ofertes te paraqitur nga Kontraktori, ne tenderin e dates 28.03.2014 "Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave urbane te qytetit te Peqinit" per volumet e percaktuara si me poshte;

Nr.	Emertimi i sherbimeve	Njesia	Volumet e punimeve	Volume/dite	Cmimi njesi	Vlera (dite)	Dite pune/vit	Vlera vjetore
1	Fshirja e rugeve, trotuareve, shesheve te pallateve dhe rrugicave ne lulishte	m2/dite	15659960	42904	0.2	8580.8	365	3,131,902
2	Fshirje ruge, trotuare shesheve te pallateve	m2/dite	6194880	43020	0.13	5592.6	144	805,334.4
3	Freskimi i rugeve nga 1 Prill – 30 Shtator	m2/dite	9676857	52879	0.16	8460.64	183	1,548,297
4	Transporti dhe largimi i mbetjeve urbane dhe tregjeve (kontenier 1.1m3)	kontenier /dite	3268	8.92 0.25	154 154	1373.7 38.6	365 48	500,005 1.853
5	Sistemim dhe manipulim i mbetjeve urbane	ton/dite	3461.5	9.7	209	2027.3	365	723,454
6	Larje, dezinfektim dhe detarizimi i konteniereve	cope/2dite /muaj	888	37	216	7992	24	191,808
								6,904,157
	T.V.SH	20%						138,831
								8,284,988

Preventivi i sherbimeve do te perdoret per llogaritjen e situacioneve qe do te paraqiten per likuidim.

Neni 7 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

Kontraktuesi bie dakort te kryejë Shërbimin e pastrimit te zones se percaktuar, objekt i kesaj kontrate, bazuar ne zerat e sherbimeve te percaktuara ne Preventiv si dhe ne perputhje me "Specifikimet teknike", grafikun e miratuar si dhe metodologjine e punes te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate.

Kontraktuesi eshte i detyruar qe brenda dates se percaktuar ne kontrate per fillimin e sherbimeve te paraqesë te gjitha mjetet, makinerite dhe pajisjet e paraqitura ne oferte sipas specifikimeve te percaktuara ne kapitullin "Specifikimet teknike".

Kontraktuesi eshte i detyruar te paraqese stafin dhe punonjesit e paraqitur ne oferte ne gadishmeri per pune ne daten e percaktuar ne kontrate per fillimin e punimeve.

Kontraktuesi eshte i detyruar te siguroje te gjithë punonjesit ne perputhje me legjislacionin shqiptar.



paraqesuesit e Kontraktuesit te cilet marrin pjese gjate kontrollit te perditshem, duhet te jene te autorizuar zyrtarisht nga Drejtori Teknik i sherbimeve te pastrimit ose administratori i shoqerise.

Kontraktuesi do te nderprese zbatimin e sherbimit te pastrimit per nje afat kohor te caktuar, ne ato raste kur per shkaqe teknike (punime per rikonstruksionin e rrugeve0 kryerja e sherbimit ose e nje pjese te sherbimit eshte e pamundur. Nderprerja e sherbimit ose modifikimi i tij, per kete rast do te kryhet vetem pas njoftimit zyrtar dhe miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkise Peqin.

Drejtori teknik i sherbimit te pastrimit eshte personi pergjegjes i cili nenshkruan te gjitha procesverbalet ditore te mbajtura nga perfaqesuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkise Peqin.

Kontraktuesi eshte i detyruar qe te kete ne cdo kohe ne gadishmeri, gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates, te gjitha mjetet dhe pajisjet e kerkuara nga kontrata ne perputhje me specifikimet teknike dhe oferten e paraqitur ne tender. Ne rast se perdorimi i nje pjese te mjeteve dhe pajisjeve eshte pamundur per shkaqe teknike per zona ose pika te caktuara, Kontraktuesi mund te ndryshoje nje pjese te mjeteve dhe pajisjeve vetem pas verifikimit dhe miratimit nga Bashkia Peqin te perngesave teknike.

Kontraktuesi eshte i detyruar te realizoje sherbimin e marre persiper ne perputhje te plote me dokumentat e tenderit pjese perberese e kesaj kontrate.

Neni 8 Lejet dhe Licensat

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose licensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve objekt i kesaj kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 9 Kerkesa e Raportimit

Kontraktuesi eshte i detyruar te paraqese raporte mujore dhe vjetore ne te cilat duhet te parashikojë listen dhe gjendjen aktuale te automjeteve dhe paisjeve te cilat perdoren per proceset e punes sipas preventivit ne perputhje me Specifikimet teknike. Ne raporte duhet te paraqiten dhe emrat dhe titujt e personelit mbikqyres te vendosur nga kontraktuesi, nje permbledhje te te gjitha rasteve te demtimeve te prones private dhe publike, demtime fizike, te cilat jane shkaktuar gjate kryerjes se veprimtarise se percaktuar ne kontrate si dhe nje permbledhje te te gjitha situacioneve te cilat ja percejell Kontraktuesit gjate kesaj kohe.

Kontraktuesi duhet ti dorezoje Autoritetit Kontraktor Bashkise Peqin 3 kopje te raportit vjetor brenda 30 diteve te fillimit te vitit te ri te kontraktimit. ne rast se Kontraktuesi nuk ka paraqitur raportin vjetor, atehere Bashkia Peqin i lind e drejta te mos beje pagesen e punes per muajt pasardhes.

Kontraktuesi duhet te dorezoje duke filluar nga data 1 e cdo muaji situacionin mujor se bashku me faturen mbi volumin e sherbimeve te kryera per muajin paraardhes, bashkengjitur se ciles do te jene faturat e ujit dhe volumin e mbeturinave te transportuara gjate muajit paraardhes, ne VDM. Bashkia Peqin me verifikimin e situacionit mujor kryen likujdimin e tij brenda 10 diteve nga dita e paraqitjes se situacionit per likujdim. Mos dorezimi i ketyre dokumentave i jep te drejten Autoritetit Kontraktor per moskryerjen e likujdimit te situacionit deri ne paraqitjen e tyre.

Kontraktuesi duhet te merret me edukimin publik ambjental per konsumatoret qe operojne brenda zones se kontrates, me qellim administrimin e mbetjeve urbane.

Kontraktuesi duhet te afishoje rregullat, tabelat, shenjat orientuese per sherbimet e pastrimit qe ofrohen ne adrese te tij.



Kontraktuesi duhet te siguroje trajtim per te gjitha te punesuarit e tij ne perputhje me te gjitha dispozitat ligjore ne fuqi te R.SH.

Kontraktuesi duhet te siguroje aprovim paraprek me shkrim nga autoriteti kontraktor perpara heqjes ose zevendesimit te personelit kryesor.

Kontraktuesi do te zevendesoje cdo punonjes ne se autoriteti kontraktor zbulon se personi ka kryer veprime te jashtligjshme ose autoriteti kontraktues eshte mjaft i pakenaqur nga puna e personelit.

Nese behet e nevojshme te zevendesohet ndonje nga personeli kryesor, kontraktuesi duhet te siguroje si zevendesues nje person me kualifikime ekuivalente ose me te mira.

Kontraktuesi do te paguaje kosto shtese per zevendesimin e personelit kryesor me perjashtim ku shkak i zevendesimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit te autoritetit kontraktor.

Te gjitha drejtuesit e mjeteve te punesuar nga kontraktuesi duhet te jene te kualifikuar per makinat e largimit te mbeturinave, duhet te kene patente te vlefshme leshuar nga autoritetet e R.SH. me kategorie perkatese.

Kontraktuesi duhet te specializojte te gjitha te punesuarit e tij, te cilet kane te bejne me mbledhjen e mbeturinave te ngurta ne menyre qe te jene ne gjendje te dallojne mbeturinat e rrezikshme te infektuara dhe te papranueshme.

Kontraktuesi duhet te pajise te gjitha punonjesit me uniforma dhe me shenja dalluese te kompanise.

Kontraktuesi duhet te beje te gjitha perpjekjet per te ndaluar punonjesit e tij te marrin, te nxisin ose te kerkojne pagim shtese nga klientet, ose persona te tjere publik per largimin e mbeturinave te ngurta.

Kontraktuesi eshte i detyruar ne punesimin e punonjesve te jape perparesi punonjesve aktuale qe punojne me pastrimin, mbledhjen dhe transportin e ketyre mbeturinave.

Kontraktuesi duhet te identifikohet ne mjete, uniforma e paisje te vena ne dispozicion, te cilat te mbajne logon, emrin dhe numrin e telefonit te Kontraktuesit.

Kontraktori eshte i detyruar te caktojte drejtorin teknik, i cili eshte personi qe Kontraktori ka percaktuar ne oferten e tij. Drejtori teknik i sherbimit te pastrimit te qytetit te Peqinit eshte Z. _____ . Detyrat e drejtorit teknik jane si me poshte;

Zbatimin e sherbimit sipas kontrates

Dokumentacionin teknik qe eshte i detyrueshem te mbahet.

Ecurine e sherbimit te pastrimit konform plan organizimit dhe grafikut te sherbimit.

Ne rast te ndryshimit te drejtuesit teknik, kontraktori duhet detyrimisht te njoftoje me shkrim autoritetin kontraktor.

Drejtuesi teknik ne kete rast duhet te kete te gjitha kualifikimet e kerkuara ne dokumentat e tenderit per Drejtuesin teknik. Autoriteti Kontraktor mund te kundershtojte emerimin e drejtuesit teknik nese vlereson se ai nuk permbush kualifikimet e percaktuara ne dokumentat e tenderit. Ne kete rast kontraktori cakton nje drejtues teknik tjetere.

Neni 11 Mbeturina te rrezikshme

Perfaqesuesit e kontraktuesit (te punesuarit e tij) kur konstatojne pranine e cdo mbeturine te papranueshme brenda dhe jashte kontinierit duhet te lajmerojne autoritetin kontraktor per keto mbeturina, infektive ose te rrezikshme ne menyre qe bashkerisht te marrin masa per largimin e tyre. Ne keto raste te dyja palet njoftojne organet kopetente perkatese.



Kontaktimi me publikun

Kontraktuesi do të ketë një seli (zyre) brenda territorit administrativ të Bashkisë Peqin, me qëllim që të komunikojë me Autoritetin Kontraktor, konsumatorin dhe publikun gjatë zbatimit të kontratës.

Kontraktuesi do të ketë ambjentin e përshtatshëm operacional për të gjitha mjetet e nevojshme të vena në dispozicion nga ana e kontraktuesit.

Neni 13 Sigurimi i përgjegjësive profesionale

Nga data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit Kontraktori duhet të ketë sigurim dhe mban përgjegjësi, sipas legjislacionit në fuqi, për:

Për dëmtime ose humbje të Shërbimeve dhe Materialeve.

Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve.

Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Shërbimeve, Materialeve dhe Pajisjeve:

Për dëmtim personal ose vdekje të personave gjatë kryerjes së shërbimeve.

Neni 14 Kontenieret, mjediset dhe pajisjet

Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin i përcakton kontraktuesit pikat e vendgrumbullimit të mbeturinave urbane (VGM) dhe numrin e kontenierëve për çdo pikë në zonën e kontraktuar në përputhje me zerat e shërbimeve të përcaktuara në preventiv, me specifikimet teknike, listën e rrugëve dhe hartën e zonës, të miratuara, pjesë të kontratës. Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin ka parashikuar paraprakisht vendosjen e 74 kontenierëve, me volum 1.1 m³, kapak metalik, rrota gome dhe llamarine të xinguar, brenda zonës së kontratës. Kontenierët e mesipër duhet të sigurohen dhe vendosen nga kontraktuesi brenda 10 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kontratës dhe kostot e blerjes dhe transportit të kontenierëve deri në VGM do të perballohen nga Kontraktori.

Kontraktuesi ka përgjegjësi për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve, kur këta të fundit demtohen për çdo rast dhe për çdo shkak. Kontraktuesi merr përsipër riparimin e të gjithë dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit.

Kontraktuesi ka përgjegjësi për larjen dhe dizinfektimin e kontenierëve në përputhje me specifikimet teknike pjesë të kontratës.

Kontraktuesi do të riparojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga autoriteti Kontraktor për dëmtimin e kontenierëve.

Në rastin e humbjes apo vjedhjes së kontenierëve, Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për zëvendësimin fizik të kontenierëve.

Në rast të mos riparimit të plote të kontenierëve (në mënyrë që të kryejnë funksionin) brenda afatit të përcaktuar me sipër nga Kontraktuesi, këtij të fundit do t'i mbahet vlera e riparimit nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.

Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin i përcakton kontraktuesit vendin e depozitimit të mbeturinave urbane të shoqëruar me certifikatën e pronësive dhe hartën treguese përkatëse.

Kontraktuesi përgjigjet për transportimin, depozitimin dhe manipulimin e mbeturinave urbane në vendin e autorizuar për depozitimin e tyre. Depozitimi i mbeturinave urbane do të kryhet gjatë gjithë javës.



Neni 15

Detyrimet e Autoritetit Kontraktor

Te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme dhe te zbatoje te gjitha procedurat per te nenshkruar kete kontrate dhe per te qene i obliguar prej saj.

Ti siguroje Kontraktuesit futjen ne zonen e kontrates, si dhe te lehtesoje komunikimin e Kontraktuesit ne zona ne te cilat do te kryeje sherbimin.

Te kryeje pagesen e sherbimit te kryer ne kohe, sipas kushteve te kesaj kontrate.

Te ndjeke cilesine dhe afatin e kryerjes se sherbimit nepermjet mbikqyresit te sherbimeve te caktuar.

Te sensibilizoj ne menyre te vazhdueshme banoret nepermjet lajmerimeve zyrtare ose mediave te shkruera dhe elektronike per mbajtjen paster te mjedisit.

Sistemimin e ambjenteve ku do te vendosen kontenieret per te mundesuar kryerjen e sherbimit.

Neni 16

Mbikqyrja gjate kryerjes se sherbimit

Autoriteti Kontraktor deklarone se ne baze te ligjeve ne fuqi **Mbikqyres i kryerjes se sherbimeve (supervisor)** do te jete Z. _____.

Supervizori i Autoritetit Kontraktor ne prani te perfaqesuesve te autorizuar te kontraktuesit, kryejne kontroll ditor te sherbimit sipas grafikeve te miratuara nga autoriteti kontraktor Bashkia Peqin, konform kontrates. Kontroll mund te ushtrojne dhe struktura te tjera brenda apo jashte organikes se Bashkise Peqin.

Supervizori mban proces-verbale dhe situacione ditore per masen e kryerjes se sherbimit, aplikojne ndalesa, gjoha dhe llogarisin masen e penalteteve per pune te pakryer sipas dispozitave te kesaj kontrate.

Situacionet ditore vendosen ne sasi sipas cdo zeri sherbimi te shprehur ne leke ne perputhje me procesverbalet ditore dhe preventivin e kesaj kontrate.

Situacionet ditore hartohen nga supervizori i Bashkise Peqin ne prani ose jo te Drejtuesit teknik te sherbimit te pastrimit, per punen e kryer, sipas orarit dhe grafikut te sherbimeve te miratuara nga te dy palet. Kontrolli i punimeve do te kryhet ne vendin dhe kohen e percaktuar nga te dy palet ne grafik. Situacionet qe nuk pranohen te nenshkruhen nga perfaqesuesi i Kontraktuesit marrin vlere dhe pa nenshkrimin e tij ne keto raste.

- kur perfaqesuesi i kontraktuesit nuk eshte prezent ne kontrollin e punes sipas grafikut.

- ne rastet e kontrollit te perbashket, kur konstatimet e supervizorit te autoritetit kontraktor nuk kontenstohen nga perfaqesuesi i kontraktuesit me ane te provave konkrete si fotografi, video me daten dhe oren e kryerjes se fotografimit ose filmimit. Ne rastin e paraqitjes se provave te mesiperme dhe te mos pranimit te tyre nga ana e supervizorit atehere kontraktuesi mund ti drejtohet me ankese Bashkise Peqin.

Situacionet mujore do te hartohen ne baze te proces-verbaleve dhe situacioneve ditore te nenshkruara nga te dy palet.

Neni 17

Menyra dhe afatet e pageses

Cmimi i kontrates do ti paguhet Kontraktuesit pas perfundimit te sherbimeve mujore, si dhe kontrollit, verifikimit te tyre nga supervizori i Autoritetit Kontraktor.

Pagesa do te behet brenda 30 diteve kalendarike nga data e perfundimit dhe miratimit te sherbimeve ne perputhje kushtet e kesaj kontrate dhe paraqitjes te:



ures origjinale tatimore te kryerjes se sherbimeve me tvsh.
situacionin mujor te paraqitur nga Kontraktuesi me vlere sipas volumeve te kryera, duke zbritur
masen e volumeve te sherbimit te pakryer si dhe penaliteteve te mbajtura per pune te pakryer, te
miratuar dhe nenshkruar nga Supervizori.

Pagesa do te behet ne numrin e llogarise te Kontraktuesit _____ ne Bank

Monedha e pagesës do të jetë LEKE.

Neni 18 Rastet e kompesuara

Supervizori ka te drejte te urdheroje Kontraktuesin per ndryshime te nevojshme te volumeve te sherbimeve dhe afatit te kryerjes se sherbimit duke ruajtur te pandryshuar vleren e pergjithshme te kontrates dhe cmimet per njesi te ofertes, per cdo ze sherbimi dhe Kontraktuesi nuk kerkon rritje te vleres se kontrates per ndryshimet e urdheruara nga Autoriteti Kontraktor.

Keto raste do te konsiderohen si raste te kompesuara per te cilat vonesa justifikohet dhe vlere e tyre do te pasqyrohet ne situacion

Neni 19 Korrigjimi i mangesive, difekteve dhe mosplotesimeve

Nese Kontraktuesi nuk ka kryer sherbimin ne perputhje me kerkesat e Specifikimeve teknike (sasi, afat, cilesi) do te njoftohet menjehere Autoriteti Kontraktor per korrigjimin e tyre nese eshte e mundur.

Moskorrigjimi i mangesive apo mosrealizimi ne menyre te perseritur dhe ne dem te Autoritetit Kontraktor perben baze per nderprerjen e kontrates.

Neni 20 Demet

Demet e mundshme ne sherbimet e kryera ose ne kryerje e siper i ngarkohen Kontraktorit, kur per to nuk eshte shkak forca madhore.

Kontraktuesi do te mbaje pergjegjesi civile dhe penale per moskryerjen e sherbimeve sipas kushteve te percaktuara ne kete kontrate dhe ne dokumentat e tenderit perkates.

Neni 21 Nderprerja e kontrates

Autoriteti Kontraktor mund ta nderprese kontraten ne cdo kohe nese kontraktuesi falimenton ose behet i paafte te kryeje sherbimet objekt i kesaj kontrate.

Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne cdo kohe nese gjykon se ky veprim duhet ndermarre per t'i sherbyer sa me mire interesit publik.

Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne teresi ose pjeserisht nese :

- Kontraktuesi deshton ne realizimin e sherbimit brenda nje muaji ose brenda zgjatjes se dhene.

- Kontraktuesi deshton te zbatoje ndonje detyrim tjeter sipas kesaj kontrate.

Autoriteti Kontraktor do ti jape Kontraktuesit njoftim me shkrim per nderprerjen per mosplotesim dhe mund ti jape Kontraktuesit 15 dite qe te ndreqe mosplotesimin.



Neni 22 Sigurimi i kontrates

Garancia e kontrates e paraqitur nga Kontraktuesi para lidhjes se kontrates, sipas modelit perkates dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10 % te vleres vjetore te kontrates ose ne vlere absolute **828.499 (teteqind e njezet e tetemije e katerqind e nentedhete e nente) leke.**Kjo shume do te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi.

Çlirimi i garancise se kontrates (10%) do te behet 30 dite, pas permbushjes se detyrimeve kontraktuale, ne perputhje me kushtet e kontrates.

Sigurimi i kontrates do te rinovohet sipas rinovimit te Kontrates

Neni 23 Vendodhja e sherbimeve

Shërbimet do të kryhen në: Qytetin e Peqinit, sipas hartes treguese te kryerjes se sherbimeve.

Neni 24 Ndryshime ne vleren e kontrates

Autoriteti Kontraktor ne fillim te cdo viti kontraktual ben rishikimin e vleres se kontrates ne perputhje me inflacionin e publikuar.Rishikimi i kontrates fillon mbas perfundimit te vitit te pare kontraktual dhe ne vazhdim bazuar ne inflacionin zyrtar te parashikuar per vitin parardhes.

Rishikimi i vleres se kontrates do te kryhet duke u bazuar ne preventivin e kontrates.Perqindja e publikuar e inflacionit vjetor i shtohet preventivit vjetor te kontrates per vitin pasardhes.

Neni 25 Zgjidhja e mosmarreshjeve

Ne rast mosmarreshjesh, kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet, kompetence per zgjidhen e tyre eshte Gjykata Administrative kopetente.

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES

Shërbimet – Procedura e Hapur

Neni 1 Qëllimi

Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të tenderit të hapur.

Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.



menyre periodike te kryeje nje reklamim ne mase te gjere, nepermjet materialeve
jitheperfshirese mbi standartet bashkekohore te mbjatjes paster te qytetit dhe ne veçanti per
grumbullimin e mbetjeve urbane, duke patur si qellim pjesmarrjen aktive te komunitetit.

Te promovoje dhe te organizoje ne menyre periodike fushata edukimi dhe informimi drejtuar
qytetareve me synim specifikimin mbi

Llojet e mbetjeve urbane si dhe menyren e diferencuar te grumbullimit te tyre.

Detyrat dhe detyrimet e qytetareve per dorezimin (nxjerrjen) konform rregullave te mbetjeve
urbane.

Qellimi mbi kryerjen e sherbimit te pastrimit te qytetit dhe menyren e kryerjes se proceseve te ketij
sherbimi.

Per kontenieret dhe vendndodhjen e tyre, nga ku te jepen orientime mbi mbetjet e grumbulluara,
menyrat e hedhjes ne kontenier dhe destinacioni i tyre.

Fushatat sensibilizuese dhe promovimet mund te realizohen:

Nepermjet tabelave ne vendgrumbullimet e mbetjeve urbane.

Nepermjet komunikimeve ne shtyp.

Nepermjet flete - palosjeve te shperndara ne komunitet.

Nepermjet formave te tjera te shperndarjes se materialeve informuese.

**Kjo kontrate u hartua ne 3 (tre) kopje origjinale, 2 (dy) prej te cilave merren nga Autoriteti
Kontraktor dhe 1 (nje) kopje nga Kontraktuesi.**

Kontrata firmoset dhe vuloset ne cdo flete nga te dyja palet.

PER AUTORITETIN KONTRAKTOR

BASHKIA PEQIN

KRYETARI

/ Ilir RRUSHI /



PER KONTRAKTUESIN

“PASTRIME SILVIO” sh.p.k.

ADMINISTRATORI

/ Bule ALLMUCA



Vlerësimi Përfundimtar



2014-05-26 12:37:13.MD

Tenders evaluation final score

Call for tenders: Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave urbane per qytetin e Peqinit

Winner: Pastrime Silvio

Accepted tenders:

Tenderer	Final score
Pastrime Silvio	20712471
VICTORIA INVEST	21023512
DU&KO	21409193

Rejected tenders:

Tenderer

Roundtrip: -> Final Evaluation

Tjetër

Ju rekomandojme ndryshimin e fjalekalimit per arsye sigurie. (Intervali 90 ditor ka skaduar)

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Keshilli i Ministrave, Tel.+ 355 4 22 77 510, email: info.app@app.gov.al

Vlerësimi Përfundimtar



2014-05-26 12:37:13.MD

Tenders evaluation final score

Call for tenders: Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave urbane per qytetin e Peqinit

Winner: Pastrime Silvio

Accepted tenders:

Tenderer	Final score
Pastrime Silvio	20712471
VICTORIA INVEST	21023512
DU&KO	21409193

Rejected tenders:

Tenderer

Roundtrip: -> Final Evaluation

Tjetër


Ju rekomandojme ndryshimin e fjalekalimit per arsye sigurie. (Intervali 90 ditor ka skaduar)

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Keshilli i Ministrave, Tel.+ 355 4 22 77 510, email: info.app@app.gov.al

*Genyrim nr. 218/14
Të Vështrimit të procedurës.*



ERASHINA PEQIN
Nr. 204 Prot.
Datë 19. 5. 2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 218/1 prot

Tiranë, më 13.05. 2014

Lënda: Dërgim Vendimi

Drejtuar: Bashkia

PEQIN

Agjencisë së Prokurimit Publik

TIRANË

;

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin nr. 218/2014 prot., datë 13.05.2014, të Komisionit të Prokurimit Publik.

KRYETAR
DENAR BIBA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
KESHILLI I MINISTRARVE
TIRANE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 218/2014

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Denar Biba	Kryetar
Vilma Kadesha	Anëtar
Denis Martopullo	Anëtar
Muharrem Çakaj	Anëtar
Hektor Muçaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.05.2014 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt: “Shërbim pastrimi dhe grumbullimi mbeturinash urbane për Qytetin e Peqinit”, me fond limit 22.247.382 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 28.03.2014, nga autoriteti kontraktor Bashkia Peqin.”

Ankimues: “Victoria Invest” sh.p.k
Rr. “11 Nëntori”, Pallati pranë Tatim Taksave, Kati II
Elbasan

Palë e ankimuar: Bashkia Peqin

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, z. Hektor Muçaj, z. Denar Biba, z. Denis Martopullo, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.03.2014 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt: “*Shërbim Pastrime dhe grumbullimi mbeturinash urbane për Qytetin e Peqinit*”, me fond limit 22.247.382 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 28.03.2014 është zhvilluar procedura e prokurimit.

Në këtë procedurë ofertuesit kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Pastrime Silvio” & “Fusha”	20.712.471 lekë, kualifikuar
“Victoria Invest”	21.023.512,77 lekë, kualifikuar
“Du & Ko”	21.409.193,4 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 01.04.2014 operatorët ekonomik pjesëmarrës janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave.

II.4. Në datën 07.04.2014 operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. Konkretisht pretendohet se:

1. *“Pastrime Silvio” sh.p.k nuk disponon kontenierë me kapak metalik, por kontenierët që disponon janë pa kapak metalik.*
2. *Në ekstraktin e QKR-së të shoqërisë “Pastrime Silvio” sh.p.k të dorëzuar në tender, kjo shoqëri rezulton me seli dhe vend të ushtrimit të aktivitetit vetëm në qytetin e Tiranës. Ndërkohë që kjo shoqëri prej disa vitesh, ushtron aktivitet në shërbimin e Pastrimet të qytetit të Peqinit (me kontratë sipërmarrje të dhënë nga autoriteti kontraktor Bashkia Peqin). “Pastrime Silvio” sh.p.k ka patur detyrimin ligjor të hapë NIPT sekondar në qytetin e Peqinit, duke bërë edhe shtimin në ekstraktin e QKR-së dhe të paguajë tekstat vendore, meqënëse po ushton aktivitet në këtë qytet.*
3. *Listpagesat e dorëzuara në tender nga “Pastrime Silvio” sh.p.k nuk janë të konfirmuara (të firmosura dhe të vulosura) të gjitha nga administrata tatimore.*
4. *Në listpagesat e paraqitura në tender, drejtuesi teknik dhe inxhinieri mekanik e kimist rezultojnë me pagë që nuk janë në bazë të VKM-së nr.285, datë 04.05.2007 “Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore...” dhe Udhëzimit nr.10, datë 21.06.2007, kur qëndra e shoqërisë është në Tiranë, në kohën kur VKM nr.285, dt 04.05.2007 dhe Udhëzimi nr.10 datë 21.06.2007 ishin me fuqi ligjore.”*

II.5. Në datën 10.04.2014, nëpërmjet shkresës nr. 98 prot., datë 08.04.2014 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.6. Në datën 16.04.2014 operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar përvec pretendimeve të ngitura në autoritetin kontraktor, edhe pretendimin si vijon:

“Kërkesat ekonomike, teknike, profesionale të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pastrime Silvio” sh.p.k & “Fusha” sh.p.k nuk janë në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në kontratën e bashkëpunimit të paraqitur në tender .”

II.7. Në datën 23.04.2014 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik shkresa nr. 127 prot., e autoritetit kontraktor me objekt: *“Dërgim informacioni”*, bashkëngjitur dokumentacioni për trajtimin e ankesës nga ana e këtij autoriteti.

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e parë të ankimesit sipas së cilës *“Pastrime Silvio” sh.p.k nuk disponon kontenierë me kapak metalik, por kontenierët që disponon janë pa kapak metalik*, Komisioni vëren se:

III.1.1 Në Shtojcën 7, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 5, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

“Kontenierë për grumbullimin e mbeturinave, me kapacitet 1.1 m³, me kapak metalik, me rrota gome, me llamarinë të xinguar; minimumi 30 copë. (Operatori ekonomik që do të shpallet fitues, duhet të plotësojë numrin prej 74 copë kontenierësh të përcaktuar në

specifikimet teknike, pjesë e dokumentave të tenderit). Për kontenierët të paraqesë faturat tatimore.”

III.1.2. Në procedurën e mësipërme të prokurimit, operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k ka paraqitur ofertë si anëtar i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Pastrime Silvio” sh.p.k & “Fusha” sh.p.k.

Sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet këtyre dy shoqërive për këtë qëllim, rezulton se:

“[...]Ato do të marrin pjesë bashkarisht në tender, duke bashkuar kapitalet, mjetet dhe aftësitë e tyre intelektuale për natyra të tilla punimesh sipas përvojës individuale dhe licencave respektive. [...] Kontributi në bashkëpunim do të jetë 30% për firmën “Fusha” sh.p.k dhe 70% për firmën “Pastrime Silvio” sh.p.k, sipas preventivit të punimeve[...].”

III.1.3. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme rezulton se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. ka paraqitur fatura tatimore shitje për 50 kazanë metalik/kontenierë me kapacitet 1.1 m3, ndërsa operatori ekonomik “Fusha” sh.p.k ka paraqitur fatura doganore për 80 kazanë plehrash metalikë.

III.1.4. Në Kreun VII “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“ [...] Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së thuhet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

Për pasojë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k., plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor lidhur me kontenierët për grumbullimin e mbeturinave. Përsa i përket kërkesës që këta kontenierë të jenë me kapak metalik, në faturat tatimore nuk jepet një përshkrim i tillë, gjë e cila nuk e përjashton mundësinë që kontenierët të jenë me kapak metalik.

Bazuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, pika 4, shkronja “gj”, në të cilën përcaktohet se “Nëse ka dyshime, autoriteti kontraktor verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesit”, është në kompetencën e autoritetit kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse, për të krijuar bindjen e tij lidhur me përmbushjen e kriterit të mësipërm.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e dytë të ankimuesit se në ekstraktin e QKR-së të shoqërisë “Pastrime Silvio” sh.p.k të dorëzuar në tender, kjo shoqëri rezulton me seli dhe vend të ushtrimit të aktivitetit vetëm në qytetin e Tiranës, ndërkohë që kjo shoqëri prej disa vitesh, ushtron aktivitet në shërbimin e pastrimit të qytetit të Peqinit (me kontratë sipërmarrje të dhënë nga autoriteti kontraktor Bashkia Peqin). “Pastrime Silvio” sh.p.k ka patur detyrimin ligjor të hapë NIPT sekondar në qytetin e Peqinit, duke bërë edhe shtimin në ekstraktin e QKR-së dhe të paguajë tekstat vendore, meqënëse po ushton aktivitet në këtë qytet”, Komisioni vëren se:

III.2.1. Në Shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar: *“Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat vendore për vitin 2013.”*

III.2.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2013, për Bashkinë e Tiranës.

III.2.3. Sipas ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Pastrime Silvio” sh.p.k, pika 7, selia e shoqërisë është në Tiranë. Ndërsa sipas pikës 16, po këtu, vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit ndodhen përsëri në Tiranë.

III.2.4. Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.2.5. Në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, thuhet shprehimisht që: *“Tatimpaguesit i kërkohet të paguajë taksën vendore mbi biznesin e vogël për çdo vendndodhje biznesi, në përputhje me nivelin tatimor të përcaktuar për llojin e biznesit dhe kategorinë e zonës gjeografike ku ai është regjistruar. Bizneset nën administrimin e të njëjtit tatimpagues që ushtrohen në një vendndodhje (në një godinë) do të taten gjithnjë si vendndodhje biznesi më vete. Një “vendndodhje biznesi” është një zonë e dallueshme dhe e ndarë si në të njëjtën godinë, ashtu edhe në godina të ndryshme.*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor në përputhje me të dhënat e aktivitetit, të regjistruara në QKR.

Përsa i përket argumentit të ankimesit se shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k ka patur detyrimin ligjor të hapë NIPT sekondar në qytetin e Peqinit, sqarojmë se ligji për sistemin e taksave vendore e përcakton qartë kriterin për pagimin e taksave lokale dhe rrjedhimisht pajisjen me NIPT sekondar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k e plotëson kriterin e kërkuar me dokumentacionin e paraqitur.

Pretendimi i parashtruar nga operatori ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e tretë të ankimesit se *listpagesat e dorëzuara në tender nga “Pastrime Silvio” sh.p.k nuk janë të konfirmuara (të firmosura dhe të vulosura) të gjitha nga administrata tatimore*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren:

III.3.1. Në Shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar: *“Një punësim mesatar vjetor jo më pak se 30 (tridhjetë) persona, të siguruar për vitet 2011, 2012, 2013. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:*

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose Sigurimet Shoqërore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj si dhe listpagesat të konfirmuara nga administrata tatimore.”

III.3.2. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm, në përputhje me volumin e shërbimit të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.3.3. Nga verifikimi i ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k dhe “Fusha” sh.p.k, rezulton se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, vetëm për vitin 2013, ka paraqitur vërtetim për numrin e punonjësve nga administrata tatimore, shoqëruar me listpagesat përkatëse për 87 punonjës mesatarisht në muaj, duke e tejkaluar kërkesën e autoritetit kontraktor sipas përqindjes së përcaktuar në akt marrëveshjen e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, cituar në pikën III.1.2. Këto listpagesa rezultojnë se janë paraqitur elektronikisht në administratën tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me listpagesat e viteve 2011 dhe 2012 të operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që kriteri plotësohet nga informacioni i paraqitur nga ky operator për vitin 2013, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk merret parasys.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se në listpagesat e paraqitura në tender, drejtuesi teknik dhe inxhinieri mekanik e kimist rezultojnë me pagë që nuk janë në bazë të VKM-së nr.285, datë 04.05.2007 “Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore...” dhe Udhëzimit nr.10, datë 21.06.2007, kur qendra e shoqërisë është në Tiranë, në kohën kur VKM nr.285, dt 04.05.2007 dhe Udhëzimi nr.10 datë 21.06.2007 ishin me fuqi ligjore, Komisioni vëren se, me VKM-në nr.393, datë 20.06.2012 është revokuar VKM nr.285, datë 04.05.2007 “Për përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të përllogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike për të punësuarit në sektorin jo publik që kryejnë punë të pakualifikuara e të kualifikuara si dhe për personelin drejtues tekniko-ekonomik të tyre.”

III.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se kërkesat ekonomike, teknike, profesionale të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pastrime Silvio” sh.p.k & “Fusha” sh.p.k nuk janë në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në kontratën e bashkëpunimit të paraqitur në tender, rezulton se ky pretendim nuk është paraqitur paraprakisht pranë autoritetit kontraktor, sikundër përcaktohet në nenin 63, pika 2 të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku thuhet: “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”

Për rrjedhojë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankimuesi nuk ka respektuar shkallët e ankimit, siç përcaktohet në nenin 63 të ligjit “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si më sipër cituar, ndaj dhe pretendimi nuk do të merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për

miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Victoria Invest" sh.p.k për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur", me objekt: "Shërbim pastrimi dhe grumbullimi mbeturinash urbane për Qytetin e Peqinit", me fond limit 22.247.382 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 28.03.2014, nga autoriteti kontraktor Bashkia Peqin.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë procedurën e prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 640 Protokolli,

Datë 16.04.2014

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK


Anëtar
Vilma Kadesha

Anëtar
Denis Martopullo

Anëtar
Muharrem Çakaj

Anëtar
Hektor Muçaj

Kryetar
Denar Biba





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Bashkia Peqin, Bulevardi "Mustafa Gjinishi", e-mail. "bashki_peqin@yahoo.com", tel.00355 5122 2217

Peqin , më 01.04.2014

VENDIM

I KOMISIONIT TE VLERESIMIT TE OFERTAVE

Per renditjen (klasifikimin) perfundimtare te ofertave ne prokurimin me objekt :
"Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave urbane per qytetin e Peqinit"

Komisioni i Vleresimit te Ofertave i ngritur me urdherin e titullarit te Autoritetit Kontraktor Bashkise Peqin, per prokurimin me objekt "Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave urbane per qytetin e Peqinit", ne zbatim te Urdherit te Prokurimit nr. __, dt. __. __.2014 "Per prokurimin e objektit "Sherbimi i pastrimit dhe grumbullimit te mbeturinave urbane per qytetin e Peqinit", zhvilloi proceduren e hapjes dhe vleresimit te ofertave te paraqitura me date 28.03.2014, procedure e cila zgjati deri me 01.04.2014.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave shqyrtoi dokumentacionin administrativo-ligjor dhe ofertat ekonomike te 3 (tre) operatoreve ekonomike ofertues dhe ne mbeshteje te Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", neni 55 dhe te VKM nr.1 dt.10.01.2007 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", Kreut V, pika 4, germa "d",

Vendosi:

1. Te vleresoje si te vlefshme ne pajtim me kerkesat e dokumentave te tenderit, ofertat e 3 (tre) operatoreve ekonomike pjesemarres: **Bashkimi i Shoqerive "DU&KO" & "Shpresa" shpk., Bashkimi i Shoqerive "Pastrime Silvio" shpk. & "Fusha" shpk. dhe "Victoria Invest" shpk.**
2. Te klasifikoj 3 (tre) ofertat e vleresuara te vlefshme ne baze te kriterit te perzgjedhjes "Çmimi me i ulet", sipas renditjes perfundimtare te meposhtme:

- Ne vend te pare oferta e operatorit ekonomik **Bashkimi i Shoqerive "Pastrime Silvio" shpk. & "Fusha" shpk.** me vleren **20,712,471 leke pa tvsh.**
- Ne vend te dyte oferta e operatorit ekonomik **"Victoria Invest" shpk.** me vleren **21,023,512.77 leke pa tvsh.**
- Ne vend te trete oferta e operatorit ekonomik **Bashkimi i Shoqerive "DU&KO" & "Shpresa" shpk.** me vleren **21,409,193.4 leke pa tvsh.**

3. Ky klasifikim perfundimtar do t'u njoftohet ne sistem 3 (tre) ofertuesve pjesemarres ne tender, te cilet nese kane pretendime ne lidhje me procedurat e ndjekura, kane te drejte te paraqesin ankese me shkrim sipas modelit standart te dhene ne dokumentat e tenderit, tek Kryetari i Autoritetit Kontraktor Bashkise Peqin brenda 7 (shtate) diteve nga marrja e njoftimit per renditjen.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave

/ Alban

Cela /

/ Erdit

Kosta /

/ Faik Deliu /